



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:071310

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05520870

C.nr.471/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Naim Rekalju, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L. G. nga Vushtrria, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av. Veton Uka me seli në Vushtrri, kundër të paditurës M., me objekt kontesti kompensim i pagës së fund vitit, jashtë seance me datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses L.G. nga Vushtrria dhe DETYROHET e paditura M., që në emër të kompensimit të pagës së fund vitit, t'ia paguajë shumën prej nga 565.21 euro për vitet 2018, 2019 dhe 2020, apo shumën totale prej 1,695.63 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga paraqitja e padisë (16.04.2021), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura M. që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro, si dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 20.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

III. Konstatohet e tërhequr padia e paditëses lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shujtës ditore.

## A r s y e t i m

Paditësja L.G. nga Vushtrria, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Veton Uka me seli në Vushtrri, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me datë 16.04.2021, kompensimin e pagës së fund vitit. Me parashtresën e datës 30.12.2021, e ka bërë zgjerimin e padisë në aspektin objektiv me të cilën ka kërkuar që përveç pagesës së pagës së fund vitit, ka kërkuar edhe kompensimin e shujtave ditore.

Gjykata me aktvendimin C.nr.471/2021, e ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, të cilin aktvendim e ka pranuar me datë 12.01.2022, ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 10.03.2022.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, sepse M.F. nuk e ka aprovuar buxhetin sipas kërkesës së Policisë së Kosovës. Si rrjedhojë e kësaj, çdo veprim apo nismë duke përfshirë edhe nenin 29 pika 2 të UA.nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare, nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore- financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të si dhe shujta ditore. Andaj, e paditura konsideron se nuk parashihet me asnjë dispozitë ligjore si detyrim-obligim i saj kompensimi i pagës së 13-të.

I autorizuari i paditëses, me parashtresën e datës 11.12.2023, kërkesën për kompensimin e shujtave ditore e ka tërhequr, ndërsa kërkesën për kompensimin e pagave të fundvitit e ka precizuar, ashtu që ka kërkuar që t'i paguhet shuma prej 565.21 euro për vitet 2018, 2019 dhe 2020, apo shumën totale prej 1,695.63 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21 euro, në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104 euro, në emër të përpilimit të parashtresës së datës 08.11.2023 shumën prej 104 euro dhe shpenzimet tjera.

Gjykata me aktvendimin C.nr.471/2021, e ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në precizimin e datës 11.12.2023, të cilin aktvendim e ka pranuar me datë 27.12.2023, ndërsa me datë 04.01.2024 ka paraqitur përgjigje ne precizim-zgjerim te kërkesës, duke e kundërshtuar ne tërësi

kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se shumat e kërkuara nuk janë realizuar për asnjërin nga punonjësit e policisë për shkak të mungesës së mjeteve financiare, përveç shpërblimit jubilar.

Gjykata, duke vepruar konform nenit 258.1 të LPK-së, në të cilin përcaktohet se *“Paditësi mund ta ndryshojë padinë më së voni deri në përfundimin e seancës përgatitore apo deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, po që se seanca përgatitore nuk është caktuar fare. Në rast të këtillë gjykata të paditurit duhet t’i jep kohë të nevojshme që të përgatitet për shqyrtim të padisë së ndryshuar”*, e lejoj ndryshimin e padisë, ku nga shumat e pa përcaktuara në petitum të kërkesëpadisë, lejoj precizimin kërkesëpadisë në emër të pagave të fund vitit në shumën e përgjithshme prej 1,695.63 euro.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, që në këtë rast rezulton se padia e paditëses është e bazuar.

Neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore ( tutje LPK) parasheh se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*, Neni 4 paragrafi 2 i LPK, parasheh se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes palëve nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura.

Në bazë të vërtetimit të punësimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me datë 25.03.2021, i cili është dorëzuar si provë nga paditësja, gjykata vërtetoi faktin se paditësja është e punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data 23.09.2002 dhe se paga momentale e saj është 565.21 €, për një muaj kalendarik.

Në bazë të të formularëve të vlerësimit të performancës për vitet 2018, 2019 dhe 2020 gjykata vërtetoi faktin se paditëses përgjatë këtyre viteve nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore.

Gjykata, vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 dhe UA nr.01/2021, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, për kërkesat e aprovuara të paditëses, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13, për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 parashihet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*. Me nenin 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 parashihet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”*.

Nga interpretimi i dispozitave të lart cituara të Udhëzimeve Administrative, të nxjerra nga e paditura dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar sepse paditësja e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitojë si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësja të ketë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës, nëse nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës.

Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësja, ka vlerësim të kënaqshëm të performancës dhe të njëjtës nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, për gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditëses për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditëses.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019 dhe 2020, gjykata mori për bazë vërtetimin e punësimit, të vlerësuar si më lart, nga i cili rezulton paga të cilën e realizon paditësja dhe përvojën e punës tek e paditura nga viti 2002, andaj paditëses i’u njoh e drejta në kompensim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara, që t’ia kompensojë paditëses, pagat e 13-ta, për fund vitet 2018, 2019 dhe 2020, andaj paditësja e ka

cilësinë e kreditorit, ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar ne nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin përcaktohet se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditëses me aplikimin e dispozitave të lartcekura dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditëses të ju kompensoi shumën e gjetuara, si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Përveç dispozitave ligjore të lartcekura, Gjykata Supreme e Kosovës me datë 09.10.2023, ka nxjerr Mendimin Juridik me nr.213/23, ku në pikën II të këtij mendimi thuhet se “*Në kontestet nga marrëdhënia e punës- lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 par.2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018,..., personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018,2019, 2020 dhe 2021.*” ndërsa në arsyetimin e tij përkatësisht në faqen 4, paragrafi i fundit thuhet se “*...e drejta për realizimin e pagës së 13-të nuk lind me plotësimin e kushteve si vlerësimi i kënaqshëm dhe mos të qenët subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore, brenda vitit përkatës, por që e drejta në shpërblimin e tillë, lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore*”, andaj, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 16.04.2021, dita e paraqitjes së kërkesëpadisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 261 paragrafi 3 të LPK, pasi që paditësja me parashtresën e datës 11.12.2023 është tërhequr nga kërkesa që ka të bëjë me kompensimin në emër të shujtave ditore.

Gjykata i vlerësoj pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoj detyrimin, me pretendim se detyrimet financiare

nga Udhëzimi Administrativ, se nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast Udhëzimet Administrative të lartcekura, janë aprovuar nga struktura të larta të te paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuara, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditëses duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat e lartcekura për derisa e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç ka kërkuar paditësja, për pjesën e aprovuar të kërkesës.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoi në dispozitën nenit 449 dhe 452 e LPK-së, sipas të cilave paditëses i pranohen shpenzimet në shumë prej 124.00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumë prej 104.00 € dhe në emër të taksës për padi shumë prej 20.00€. Gjkata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, përkatësisht shumë prej 104.00 € në emër të precizimit të kërkesëpadisë, sepse gjykata vlerësoj se nuk ka bazë një gjë e tillë, ngase sipas nenit 253 paragrafi 1 të LPK, parashihet se padia duhet të përmbaj kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.471/2021, me datë 28.03.224

Gj y q t a r i  
Naim Rekaliu

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.